

Afatet dhe Kushtet e Përgjithshme të Blerjes të "Bayer d.o.o.", zyra e përfaqësimit në Tiranë, me adresë: Rr. e Elbasanit, nr. 60, P. Gerard-A. 1, shk 1/1, 1001 Tiranë

1. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

- 1.1 Këto afate dhe kushte ("Afatet dhe Kushtet e Blerjes") janë përfshirë, si referuar në kontratën së blerjes ose çfarëdo kontrate tjetër të lidhur për blerjen e mallrave dhe/ose shërbimeve ("Kontrata"), lidhur ndërmjet "Bayer d.o.o.", zyra e përfaqësimit Tiranë, me adresë në Rr. e Elbasanit, nr. 60, P. Gerard-A. 1, shk 1/1, 1001 Tiranë ("Blerësi"), sipas legjislacionit në fuqi që përfshin këto Afate dhe Kushte, dhe palës tjetër kontraktore ("Furnizuesi").
- 1.2 Këto Afate dhe Kushte të Blerjes zbatohen ekskluzivisht. Këto Afate dhe Kushte të Blerjes nuk zbatohen vetëm nëse, dhe në masën që është rënë dakord për vlefshmërinë e afateve dhe kushteve të veçanta të Blerësit. Në atë rast, Afatet dhe Kushtet e Blerjes zbatohen vetëm si plotësuese dhe kanë natyrë dytësore.
- 1.3 Afatet dhe kushtet konfliktuale ose të ndryshme të Furnizuesit, ose afatet dhe kushtet e tjera, ose afatet dhe kushtet e tjera të përgjithshme tregtare të furnizuesit nuk njihen. Afatet dhe kushtet konfliktuale ose të ndryshme zbatohen vetëm nëse Blerësi i ka pranuar ato në mënyrë individuale shprehimisht me shkrim në. Kjo dispozitë zbatohet edhe nëse mallrat dhe/ose shërbimet pranohen nga Blerësi në dijeni të afateve dhe kushteve të përgjithshme tregtare të Furnizuesit.
- 1.4 Marrëveshjet kontraktore individuale kanë gjithmonë përparësi kundrejt Afateve dhe Kushteve të Blerjes.

2. DISPOZITAT E MARRËVESHJES

- 2.1 Asnjë marrëveshje ose garanci e shprehur në mënyrë verbale nga Blerësi përpara lidhjes së Marrëveshjes nuk është ligjërisht detyrueshme. Të gjitha këto marrëveshje ose garanci zëvendësohen plotësisht nga Marrëveshja. Dispozita e mësipërme nuk zbatohet nëse garancitë cilësojnë shprehimisht se kanë si synim të mbeten detyruese, ose nëse garancitë konfirmohen shprehimisht me shkrim nga Blerësi.
- 2.2 Dispozitat e Afateve dhe Kushteve të Blerjes që i referohen shprehimisht një kategorie specifike blerjesh (p.sh. blerjes së mallrave, blerjes së punimeve dhe materialeve, shërbimeve të punës, pajisjeve ose shërbimeve të përgjithshme) zbatohen ekskluzivisht për llojin përkatës të kategorisë së blerjeve. Përndryshe, dispozitat e përcaktuara më poshtë zbatohen për të gjitha llojet e kategorive të blerjeve.

3. OFERTA E FURNIZUESIT

- 3.1 Furnizuesi e drejton ofertën e tij sipas kërkesës së Blerësit.
Oferta duhet të përgatitet dhe dorëzohet pa pagesë. Oferta nuk krijon ndonjë detyrim për Blerësin potencial. Kostot e propozuara mbulojnë vetëm me marrëveshje të shprehur paraprake.
- 3.2 Nëse në një rast individual dhe pavarësisht nga dispozitat e Seksionit 17.1 kostot dhe shpenzimet e palëve të treta duhet të kompensohen, ato duhet të paraqiten në ofertë, të ndara sipas sasisë dhe me tregues të çmimit për njësi dhe çmimit total.

4. URDHRI I BLERJES DHE PRANIMI

- 4.1 Furnizuesi kontrollon çdo urdhër blerjeje të marrë nga Blerësi për gabime të dukshme, paqartësi, mangësi dhe papërshtatshmëri të specifikimeve të përdorura nga Blerësi për qëllimin e synuar. Furnizuesi njofton menjëherë Blerësin për çdo ndryshim ose sqarim të nevojshëm në urdhrin e blerjes.
- 4.2 Çdo urdhër blerjeje dhe/ose urdhër blerjeje i ndryshuar që refuzon një ofertë të mëparshme të Furnizuesit duhet të pranohet me shkrim nga Furnizuesi. Fillimi i ekzekutimit të urdhrin të blerjes nga Furnizuesi konsiderohet i barasvlershëm me pranimin e shprehur të ofertës nga Furnizuesi.

- 4.3 Furnizuesi duhet të tregojë informacionin e mëposhtëm në të gjithë korrespondencën: Departamentin e blerjeve, numrin e plotë të urdhrin të blerjes, datën e urdhrin të blerjes dhe referencën e Blerësit.
- 4.4 Blerësi ka të drejtë të kërkojë modifikime të mallrave ose shërbimeve me të cilat do të furnizohet edhe pas lidhjes së Marrëveshjes, me kusht që diçka e tillë të jetë brenda pritshmërive të arsyeshme të Furnizuesit. Këto ndryshime në Marrëveshje do të marrin në konsideratë efektet për të dyja palët, në veçanti, do të merren parasysh ritjet ose uljet e kostos dhe ndikimet në planin përkatës të përbushjes së detyrimeve të palëve.
- 4.5 Urdhri i Blerjes nuk autorizon Furnizuesin të përfaqësojë Blerësin.

5. KRYERJA E SHËRBIMEVE NGA FURNIZUESI DHE NËNKONTAKTORËT

- 5.1 Furnizuesi duhet t'i kryejë vetë shërbimet ose t'i kryejë ato me anë të palëve të treta pjesë strukturës dhe nën përgjegjësinë e tij. Furnizuesi është i autorizuar të angazhojë nënkontraktorë vetëm me miratimin e shprehur paraprak të Blerësit. Nëse Blerësi miraton angazhimin e nënkontraktorëve, ata kontraktohen për ofrimin e shërbimit nga Furnizuesi në emër dhe për llogari të tij.
- 5.2 Nëse shërbimi realizohet në vendndodhjen e Blerësit, Furnizuesi duhet të përbushë kërkesat e sigurisë dhe organizimit për shoqëritë e treta dhe/ose me rregulloret e brendshme të operimit që janë të zbatueshme në vendet përkatëse të performancës. Furnizuesi duhet të përbushë gjithashtu të gjitha kërkesat e tjera për të cilat vihet në dijeni në vendin e performancës. Nëse Furnizuesi i konsideron kërkesat si të paarsyeshme, ai duhet t'i paraqesë menjëherë Blerësit kundërshtimet e tij.
- 5.3 Furnizuesi angazhon vetëm persona të kualifikuar përzakësitim dhe shërbimit. Personat, të cilëve iu është ndërprerë më parë marrëdhënia e punës me Blerësin, nga ana e këtij të fundit, për arsye që lidhen me personelin ose performancën, nuk mund të angazhohen, ashtu sikurse edhe personat që kanë dëmtuar në mënyrë të përsëritur ose vazhdojnë të shkaktojnë dëme shumë serioze ndaj interesave të Blerësit. Furnizuesi përballon çdo kosto të shtuar që rezulton nga një zëvendësim i personelit të angazhuar për ekzekutimin e shërbimit.

6. KOHA E KRYERJES SË SHËRBIMIT DHE E DORËZIMEVE

- 6.1 Nëse është parashikuar një periudhë e caktuar kohore për ofrimin e shërbimit, përveç rasteve kur është rënë dakord ndryshe, kjo periudhë fillon sapo Furnizuesi merr urdhrin e blerjes.
- 6.2 Sapo Furnizuesi të kuptojë se nuk mund të përbushë më tërësisht ose pjesërisht detyrimet e tij kontraktuale, ose se nuk mund t'i përbushë ato në kohën e duhur, ai duhet të njoftojë menjëherë Blerësin për këtë duke treguar arsyet dhe kohëzgjatjen e parashikuar të vonësës. Njoftimi duhet të bëhet me shkrim. Nëse Furnizuesi nuk arrin ta bëjë këtë njoftim, ai nuk mund të parashtrojë pengesën si shkakun e vonësës përpara Blerësit.
- 6.3 Nëse Furnizuesi nuk i përbush detyrimet brenda afatit të caktuar, ai do të mbajë përgjegjësi në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi. Blerësi autorizohet gjithashtu që, në rast vonese në ekzekutim ose dërgesë, pas njoftimit paraprak me shkrim të Furnizuesit, të vendosë një penalitet kontraktual në masën 0,5%, që nuk kalon 5% të shumës së urdhrin të blerjes, për çdo javë ose pjesë të saj që vonon ekzekutimin ose dërgesën, përveç rastit kur Furnizuesi nuk është përgjegjës për vonësën. Çdo penalitet kontraktor i paguar në përputhje me këtë dispozitë, do të kreditohet si kompensim për ekzekutimin me vonësë, i cili duhet të paguhet nga Furnizuesi. Penaliteti kontraktor mund të paguhet deri në afatin e pagesës përfundimtare, pa pasur nevojë për të mbajtur ndonjë garanci në lidhje me penalitetin në fjalë.
- 6.4 Shërbimet dhe/ose dërgesat e pjeshme pranohen vetëm me marrëveshje të shprehur.
- 6.5 Nëse përcaktohet një afat për dorëzimin, Blerësi rezervon të drejtën për të kthyer mallrat e dorëzuara para kohe me shpenzimet e Furnizuesit. Nëse Blerësi vendos të mos i kthejë dërgesat e parakohshme, mallrat do të ruhen

- deri në datën e caktuar të dorëzimit me shpenzimet dhe riskun e Furnizuesit.
- 7. VENDI I EKZEKUTIMIT**
- Vendi i ekzekutimit, për të gjitha pretendimet që lindin sipas kësaj Marrëveshjeje, është për të dyja palët vendi i specifikuar nga Blerësi (d.m.th. adresa e dorëzimit e vendosur në urdhrin e blerjes ose e përcaktuar ndryshe).
- 8. BASHKËPUNIMI NGA ANA E BLERËSIT**
- 8.1 Blerësi duhet të sigurojë bashkëpunimin e përcaktuar në kontratë. Nëse nuk është rënë dakord ndryshe, ky bashkëpunim është detyrueshëm.
- 8.2 Nëse Blerësi nuk siguron, ose nuk ofron siç duhet shërbimet e nevojshme të bashkëpunimit, Furnizuesi duhet të paraqesë menjëherë, me shkrim, ankesën e tij. Nëse Furnizuesi nuk e përbush këtë kërkesë për të paraqitur ankesat e tij, Blerësi nuk do të konsiderohet se është në mospërbushje të detyrimit të tij për të bashkëpunuar dhe Furnizuesi nuk mund të pretendojë mungesë bashkëpunimi.
- 9. TESTIMET DHE INSPEKTIMET**
- Nëse janë përcaktuar testime dhe inspektime për mallrat ose shërbimet që do të furnizohen, Furnizuesi mbulon kostot materiale dhe të personelit përgjegjës për testimet dhe inspektimet. Blerësi duhet të mbulojë kostot e personelit të tij të testimeve dhe inspektimit. Furnizuesi duhet t'i dërgojë Blerësit një njoftim të detyrueshëm se shërbimi ose mallrat janë gati për t'u testuar ose inspektuar, të paktën një javë përpara datës së përcaktuar për testimin ose inspektimin. Furnizuesi duhet gjithashtu të bjerë dakord me Blerësin për një datë testimi. Nëse artikulli që do të testohet nuk paraqitet në këtë datë, kostot e personelit të Blerësit që do të kryejnë testimin i ngarkohen Furnizuesit. Nëse identifikohen defekte dhe nevojiten prova shtesë ose të përsëritura, Furnizuesi është përgjegjës për të gjitha kostot materiale dhe ato të personelit. Furnizuesi mbulon kostot materiale dhe të personelit lidhur me certifikatat e materialeve për lëndët e para.
- 10. PAKETIMI DHE TRANSPORTI**
- 10.1 Veçmas nga mallrat dhe fatura, Furnizuesi duhet të dërgojë një njoftim të plotë të dërgesës për çdo dërgesë në datën e speditimit. Çdo dërgesë shoqërohet me faturat e ngarkesës dhe listat e paketimit. Për dërgesat me anije, duhet të tregohet emri i shoqërisë së transportit dhe i anijes në dokumentet e transportit dhe në faturë. Furnizuesi duhet të zgjedhë mënyrat më të mira dhe më të përshtatshme të transportit për Blerësin. Referencat e urdhrin të blerjes dhe informacioni mbi pikën e shkarkimit të specifikuar nga Blerësi duhet të tregohen të plota në njoftimet e transportit, faturat e dorëzimit të ngarkesës, listat e paketimit, fletët shoqëruese, faturat financiare dhe në paketimin e jashtëm.
- 10.2 Furnizuesi duhet ta paketojë, etiketojë, magazinonë, ruajë dhe dërgojë gjithmonë produktin në përputhje me ligjet në fuqi dhe sipas specifikimeve të produktit, duke përfshirë kërkesat specifike të produktit për paketimin, magazinimin dhe transportimin. Nëse kërkohet nga ligjet në fuqi, dokumentet shoqëruese duhet të tregojnë kategorinë e rrezikut dhe të gjitha të dhënat e mëtejshme. Për këtë mund të përfshihet paraqitja e një flete të dhënash të vlefshme dhe të plota të sigurisë materiale të produktit.
- 10.3 Mallrat duhet të paktohen për të parandaluar dëmtimin gjatë transportit. Materialet e paketimit duhet të përdoren vetëm në masën e nevojshme për të arritur këtë qëllim. Furnizuesi duhet ta rimarrë materialin e paketimit në përputhje me ligjin dhe rregulloret në fuqi. Nëse, sipas kushteve të një marrëveshjeje të shprehur, Blerësi paguan kompensim të veçantë për materialin e paketimit, ai ka të drejtë t'i kthejë Furnizuesit materialin e paketimit në gjendje të mirë për një rimbursim në masën 75% të çmimit të faturuar, pengarkesëtë parapaguar. Peshat maksimale e çdo paketimi është 10 kg.
- 10.4 Në përgjithësi, Furnizuesi duhet t'i paketojë, identifikojë dhe dërgojë produktet e rrezikshme / mallrat e rrezikshme ("Mallrat e rrezikshme") në përputhje me kërkesat kombëtare/ndërkombëtare të aplikueshme në lidhje me klasifikimin, etiketimin e paketimit, ruajtjen dhe transportin e Mallrave të Rrezikshme ("Transportin dhe Trajtimin"). E njëjta gjë vlen edhe për krijimin dhe nënshkrimin e dokumentacionit të detyrueshëm të transportit në lidhje me Mallrat e Rrezikshme, pavarësisht nga Incoterm-i i rënë dakord. Aty ku rregulloret të tilla nuk ekzistojnë, do të zbatohen Rekomandimet e OKB-së për Transportin e Mallrave të Rrezikshme, Rregulloret Model.
- 10.5 Furnizuesi është përgjegjës për dëmet dhe merr përsipër të gjitha kostot e shkaktuara si rezultat i mosrespektimit të këtyre rregulloreve. Furnizuesi është gjithashtu përgjegjës për pajtueshmërinë e nënkontraktorëve të tij me këto rregullore.
- 10.6 Të gjitha dërgesat që nuk mund të pranohen si rezultat i mosrespektimit të këtyre rregulloreve nga ana e Furnizuesit do të vendosen në magazinim me shpenzimet dhe rrezikun e Furnizuesit. Blerësi ka të drejtë të konstatojë përbajtjen dhe gjendjen e dërgesave të tilla.
- 11. PAJTUESHMËRIA ME RREGULLOREN REACH DHE ME AKTE LEGJISLATIVE TË NGJASHME**
- 11.1 Nëse Furnizuesi është furnizues sipas kuptimit të nenit 3, nr. 32 të Rregullores REACH (Rregullorja (KE) 1907/2006), ai ka përgjegjësinë të përbushë detyrimet e tij në lidhje me dërgimin e mallrave. Në veçanti, ai duhet, në të gjitha rastet e trajtuara në nenin 31, paragrafët 1 deri në 3 të Rregullores REACH, t'i paraqesë Blerësit një Fletë të të Dhënave të Sigurisë sipas nenit 31 të Rregullores REACH, në gjuhën e vendit pritës, dhe të veprojë në përputhje me detyrimin e tij të informimit, në përputhje me nenin 32 të Rregullores REACH, për materialet, individuale dhe në përzierje, për të cilat nuk kërkohet Fletë e të Dhënave të Sigurisë.
- 11.2 Furnizuesi duhet të garantojë se të gjitha substancat e përbajtura në mallrat objekt dërgimi janë të regjistruara në mënyrë efektive në përputhje me kërkesat në fuqi të Art. 6 të Rregullores REACH për përdorimet e treguara nga Blerësi, përveç rasteve kur ato janë të përjashtuara nga detyrimi i regjistrimit, dhe se ato kanë autorizimet e nevojshme. Kërkesa e mësipërme zbatohet, sipas rastit, për substancat e çliruara nga produktet, sipas kuptimit të nenit 7 të Rregullores REACH.
- 11.3 Furnizuesi duhet të njoftojë menjëherë Blerësin nëse përbërësit e një artikulli të furnizuar nga Furnizuesi përbajnë një substancë në një përqendrim më të madh se 0,1 për qind sipas peshës (p/p) që plotëson kriteret e neneve 57 dhe 59 të Rregullores REACH, ose është renditur në Shtojcën XIV të Rregullores REACH. Të njëjtat kërkesa zbatohen për materialet e paketimit.
- 11.4 Nëse Furnizuesi nuk është furnizues sipas kuptimit të Rregullores REACH (Rregullorja (KE) 1907/2006), ai do të jetë përgjegjës për pajtueshmërinë me të gjitha detyrimet e barasvlefshme të parashikuara në paragrafët 11.1 deri në 11.3 të kësaj Marrëveshjeje sipas legjislacionit në fuqi për menaxhimin e substancave kimike në Shqipëri, duke përfshirë, por pa u kufizuar, legjislacionin e përafuar me Rregulloren REACH.
- 12. SIGURIMI**
- 12.1 Në përputhje me transferimin e rrezikut sipas INKOTERMAVE/kushteve të përcaktuara të dorëzimit, Pala përkatëse merr përsipër rrezikun për humbjen ose dëmtimin e mallrave. Nëse palët nuk bien dakord ndryshe, zbatohet klauzola e "DDP Incoterms".
- 12.2 Furnizuesi duhet, që me shpenzimet e tij, të sigurojë përgjegjësinë, në përputhje me standartin e aplikueshëm në sektorin e tij, për të mbuluar dëmin e shkaktuar nga shërbimet ose puna e ekzekutuar ose pasuria në pronësi të tij, e personelit të tij ose nënkontraktorëve të tij si rezultat i shërbimeve të ekzekutuara, ose punës apo mallrave të dorëzuara. Dëshmia e mbulimit të sigurimit duhet t'i jepet Blerësit me kërkesë të këtij të fundit. Pretendimet për dëme të tjera, në tejkallim të dëmit të mbuluar nga sigurimi, të cilat mund të pretendohen nga Blerësi, mbeten të paprekura.

- 12.3 Blerja e policave të posaçme të sigurimit për mbulimin e instalimeve/strukturave , përveç mbulimit të përgjegjësive të përcaktuar në seksionin, 12.2 duhet të koordinohet ndërmjet Blerësit dhe Furnizuesit në çdo rastspecifik.
- 12.4 Objektet e dhëna hua Blerësit, duke përfshirë, por pa u kufizuar të makineritë dhe pajisjet që përdoren në vendet e punës, duhet të sigurohen nga Blerësi ndaj rreziqeve standarde. Blerësi nuk do të ketë asnjë përgjegjësi të mëtejshme për humbjen ose dëmtimin e këtyre objekteve, përveç rasteve të dëmtimeve me dashje ose si pasojë e pakujdesisë së rëndë.
- 13. NDALIMI I TRANSFERIMIT TË PUNONJËSVE, PAGA MINIMALE**
- 13.1 Blerësi nuk ka autoritet mbikëqyrës mbi punonjësit e Furnizuesit. Furnizuesi duhet të sigurojë që asnjë person i punësuar prej tij për ofrimin e shërbimit të mos jetë i përfshirë në veprimtaritë e Blerësit. Kërkesa e mësipërme zbatohet veçanërisht nëse personat e punësuar nga Furnizuesi i ofrojnë shërbimet në zyrat e Blerësit ose në pronën e tij.
- 13.2 Furnizuesi është përgjegjësi i vetëm për detyrimet kontraktuale, ligjore, zyrtare dhe profesionale kundrejt personave të punësuar prej tij për ofrimin e shërbimit. Furnizuesi duhet ta mbajë Blerësin plotësisht të padëmtuar nga pretendimet që mund të ngrihen kundër Blerësit si rezultat i shkeljes së detyrimeve të mësipërme. Ky detyrim i mbajtjes së padëmtuar zbatohet veçanërisht për detyrimet e lidhura me pagesën e pagave dhe/ose roqave dhe/ose me të gjitha detyrimet e tjera të pagesave që rrjedhin nga marrëdhëniet e punësimit ose të shërbimit (si p.sh. kontributet e sigurimeve shoqërore). Ky detyrim zbatohet gjithashtu për të gjitha pretendimet që lindin nga punësimi i punonjësve.
- 13.3 Furnizuesi duhet të njoftojë Blerësin sapo të bëhet e dukshme se mund të supozohet pseudo vetëpunësimi i Furnizuesit nga Blerësi apo se ekzekutimi i shërbimit nga Furnizuesit mund të cilësohet si punë e nënkontraktuar.
- 13.4 Furnizuesi duhet të sigurojë respektimin e dispozitave ligjore përkatëse që janë në fuqi në Shqipëri në lidhje me pagën minimale. Kërkesa e mësipërme zbatohet gjithashtu nëse dhe në masën që Furnizuesi angazhon një nënkontraktor për këto shërbime, megjithatë në atë rast, nënkontraktori mban përgjegjësi të plotë dhe ekskluzive për çdo pretendim në lidhje me pagën minimale... Furnizuesi mban Blerësin e padëmtuar nga çdo pretendim në lidhje me pagën minimale.
- 14. DOKUMENTET E BLERËSIT**
- 14.1 Blerësi rezervon të gjitha të drejtat e pronësisë industriale dhe të drejtën e autorit për të gjitha dokumentet të transmetuara fizikisht ose elektronikisht Furnizuesit. Blerësi ruan të drejtat e pronësisë mbi të gjitha vizatimet, standardet, udhëzuesit, metodat e analizës, formulat dhe dokumentet e tjera që Blerësi i transmeton Furnizuesit për prodhimin e produktit që do të dorëzohet. Dokumentet e Blerësit u nënshtrohen gjithashtu kërkesave të përcaktuara në seksionin 25. Dokumentet mbi të cilat Blerësi ruan të drejtën dhe/ose që përmbajnë sekretet e tij të biznesit dhe operimit në vizatime, standarde, udhëzues, metoda analize, formula dhe dokumente të tjera mund të përdoren, kopjohen ose të bëhen të aksesueshme për palët e treta nga Furnizuesi, vetëm për qëllimet e Blerësit të përcaktuara me kontratë. Kërkesat e tjera zbatohen vetëm me miratimin me shkrim të Blerësit. Të gjitha kopjet dhe riprodhimet që janë të nevojshme për zbatimin e Marrëveshjes, ose që nuk kërkohen më sipas detyrimeve ligjore të ruajtjes duhet t'i kthehen menjëherë Blerësit dhe/ose - në rastin e dokumenteve elektronike - të fshihen, sipas kërkesës.
- 14.2 Të gjitha llojet e dokumenteve që kërkohen nga Blerësi për përdorimin, konfigurimin, ngritjen ose instalimin, përpunimin, magazinimin, funksionimin, mirëmbajtjen, inspektimin, shërbimin dhe riparimin e produkteve të furnizuar, duhet të vihen në dispozicion nga Furnizuesi menjëherë, pa kërkesë dhe pa pagesë.
- 14.3 Standardet e brendshme të Blerësit (standardet e shoqërisë) dhe udhëzimet duhet të kërkohen nga Furnizuesi në kohën e duhur, në masën në të cilën ato nuk janë bërë ende të aksesueshme ose nuk janë transmetuar.
- 14.4 Dokumentet e transmetuara nga Blerësi duhet të kthehen pa qenë nevoja e një kërkesë, dhe/ose - në rastin e dokumenteve elektronike - të fshihen prej Furnizuesit, duke iu nënshtruar detyrimit të përcaktuar në seksionin 15 dhe/ose detyrimeve ekzistuese ligjore të ruajtjes, jo më vonë se në kohën e ekzekutimit të urdhrin.
- 15. DETYRIMI I RUAJTJES SË DOKUMENTEVE TË BLERËSIT**
- Të gjitha dokumentet e krijuara nga Furnizuesi në kontekstin e Marrëveshjes, (p.sh. drafte, skica, kopje filmike, regjistrime audio dhe modele përfundimtare) dhe të dhënat e transmetuara Blerësit, duhet të ruhen nga Furnizuesi edhe për tre (3) vite të tjera përtej afatit ose përfundimit të Marrëveshjes dhe të vihen në dispozicion pa pagesë pas një kërkesë të veçantë nga Blerësi.
- 16. SIGURIMI I CILËSISË**
- 16.1 Furnizuesi duhet të krijojë dhe të mbajë një program efektiv të Sigurimit të Cilësisë (p.sh. në përputhje me ISO 9000 dhe në vijim. ose të barasvlefshëm). Furnizuesi duhet t'i tregojë Blerësit masat përkatëse sipas kërkesës.
- 16.2 Vetë Blerësi ka të drejtë të verifikojë masat e Sigurimit të Cilësisë me anë të një takimi ose t'i verifikojë ato me anë të palëve të treta të angazhuara nga Furnizuesi.
- 16.3 Furnizuesi duhet të njoftojë Blerësin përpara se të bëjë ndonjë ndryshim në lëndët e para, burimin e lëndëve të para, metodat e prodhimit, pajisjet e prodhimit ose vendndodhjet e përfshira në ekzekutimin e një urdhri blerjeje dhe të marrë miratimin e Blerësit që këto ndryshime të mos e bëjnë përdorimin e mallrave dhe/ose shërbimeve të papërshtatshëm për Blerësin përpara se të implementojë ndryshime të tilla. Blerësi mund ta zgjidhë urdhrin e blerjes, nëse Furnizuesi nuk është dakord për diçka të tillë.
- 16.4 Furnizuesi duhet të sigurojë që të gjitha pajisjet dhe kontejnerët të pastrohen me kujdesin maksimal përpara çdo ndryshimi të produkteve. Furnizuesi vepron në përputhje me të gjitha ligjet në fuqi, duke përfshirë udhëzimet më të fundit për parandalimin e kontaminimit në Prodhimin e Produkteve për mbrojtjen e të Korrave, që gjenden në linkun: <https://croplife.org/?s=guidelines> dhe -për aq sa e lejon ligji dhe ku është e zbatueshme- njofton Blerësin se cili produkt tjetër është trajtuar, përpunuar ose ruajtur më parë në pajisjet dhe në kontejnerët në fjalë. Më tej, Furnizuesi njofton menjëherë Blerësin për çdo rrezik kontaminimi ose çdo dyshim për kontaminim.
- 17. KOMPENSIMI**
- 17.1 Përveç rasteve kur është rënë dakord shprehimisht ndryshe me shkrim, kompensimi i detyruar është një çmim fiks. Çmimet fikse përfshijnë gjithashtu shpenzimet, kostot e energjisë, kostot e lëndëve të para, kostot e palëve të treta, kostot e udhëtimit dhe shpenzimet e vogla të xhepit, si dhe paketimin dhe dërgimin e mallrave me pagesë. Çmimet fikse përfshijnë gjithashtu kompensimin për skicat dhe draftet (duke përfshirë skicat me laps ose vizatimet e ruajtura në media elektronike, përfshirë të dhënat e imazhit). Marrëveshjet me çmim fiks janë gjithashtu të vlefshme për përllogaritjet e përafërta të përgatitura nga Furnizuesi përpara lidhjes së Marrëveshjes, përveç rastit kur këto përllogaritje të përafërta identifikohen shprehimisht si jodetyruese. Çdo kosto e shtuar e nevojshme për ekzekutimin e shërbimit mbulohet nga Furnizuesi.
- 17.2 Nëse nuk është përcaktuar një çmim fiks, kostot e udhëtimit rimburohen vetëm në bazë të miratimit paraprak me shkrim të Blerësit, sipas kushteve të Blerësit për rimbursimin e kostove të udhëtimit.
- 17.3 Nëse çmimet e Furnizuesit ulen ose kushtet e Furnizuesit përmirësohen gjatë periudhës ndërmjet urdhrin të blerjes dhe dorëzimit, çmimet dhe kushtet në fuqi në datën e dorëzimit zbatohen edhe për Blerësin. Dispozita

e mësipërme zbatohet në përputhje me rrethanat për shërbimet, kostot dhe shpenzimet e miratuara individualisht për palët e treta.

18. KUSHTET E PAGESËS

- 18.1 Faturat duhet të përmbajnë numrin e urdhrit të blerjes që tregohet në urdhrin e blerjes dhe të përshkruajnë me detaje elementet e shërbimit ose mallrave. Faturat duhet gjithashtu të përkojnë me gjuhën, renditjen e artikujve të faturës dhe çmimet e paraqitura në urdhrin e blerjes. Çdo shërbim ose mall i shtuar ose i reduktuar duhet të renditet veçmas në faturë.
- 18.2 Faturat të cilat nuk shprehen në monedhën vendase duhet të kenë kursin e këmbimit ndërmjet valutës së huaj/monedhës vendase ose shumën e TVSH-së në monedhën vendase.
- 18.3 Nëse në rastin konkret, palët bien dakord me shkrim, pavarësisht nga dispozitat e seksionit 17.1, që Blerësi të rimbursojë shpenzimet nga xhepi, kostot e shërbimeve të palëve të treta dhe shpenzime të tjera, këto shpenzime duhet të tregohen në faturë, të ndara sipas artikullit, sasisë, njësisë dhe çmimeve totale dhe të dokumentuara me kopje të faturave ose kuponëve përkatës.
- 18.4 Periudhat e pagesës fillojnë nga një datë e caktuar, por jo më herët se data e marrjes së mallrave ose e pranimit të tyre dhe në asnjë rast para marrjes së faturës, dhe, - nëse parashikohet-, para përcjelljes së certifikatave të analizës dhe/ose dokumentacionit të prodhimit.
- 18.5 Pagesat duhet të paguhën brenda 30 (tridhjetë) ditëve neto pas marrjes së faturës, përveç rasteve kur dispozita në seksionin 18.4 rezulton me një datë pagese të mëvonshme.
- 18.6 Palët mund të devijojnë nga kushtet e pagesës të përcaktuara në seksionin 18.5 nëse bien dakord shprehimisht, për shembull në hapësirën e tekstit të një urdhër blerjeje.
- 18.7 Pagesa e Blerësit do të konsiderohet në vonesë nëse Blerësi ka marrë një paralajmërim të shprehur pas datës kur duhet të ishte kryer pagesadhe/ose në tejkallim të afatit kur është parashikuar një afat fiks pagese. Shuma totale e normës së interesit për pagesën me vonesë, llogaritur mbi shumën e përgjithshme që zbatohet në rastin e vonesës së pagesës, është norma ligjore e interesit për pagesë me vonesë mbi shumën e përgjithshme në Shqipëri prej 8 pikë përqindjeje mbi normën bazë të interesit të përcaktuar në ligjin ne fuqi për vonesat e pagesës në detyrimet tregtare dhe kontraktuale, përveç rasteve kur Blerësi dëshmon se dëmi material real i shkaktuar nga Furnizuesi ishte më i vogël.
- 18.8 Në rast dërgesash me defekt, Blerësi ka të drejtë të mbajë pagesën në mënyrë proporcionale deri në mbërritjen e dërgesës së duhur.
- 18.9 Pagesa nuk përbën pranim tëafateve , kushteve ose çmimeve. Data e pagesës nuk ka efekt mbi fillimin e periudhave të garancisë dhe nuk përfaqëson as pranim të pakufizuar të objektivit të dorëzuar dhe as heqje dorë nga pretendimet e mundshme të garancisë.
- 18.10 Nëse nuk parashikohet ndryshe, faturat lëshuar Blerësit përkatës duhet t'i dërgohen me postë shoqërisë porositëse.

19. RUAJTJA E TË DREJTËS SË PRONËSISË

- 19.1 E drejta e pronësisë mbi mallrat duhet t'i transferohet Blerësit pa kufizime dhe pavarësisht pagesës së çmimit.
- 19.2 Nëse, sipas kushteve të një marrëveshjeje individuale, shitësi ofron transferimin e të drejtës së pronësisë të kushtëzuar nga pagesa e çmimit të blerjes, rezervimi i të drejtës së pronësisë nga ana e Furnizuesit skadon jo më vonë se data e pagimit të çmimit të blerjes për mallrat e dorëzuara. Blerësi gjithashtu mbetet i autorizuar, edhe përpara pagesës së çmimit të blerjes, të rishesë mallrat në rrjedhën e zakonshme të biznesit, duke përfshirë kalimin paraprak të shumës që rezulton nga rishitja; përndryshe ruajtja e të drejtës së pronësisë shtihet edhe tek rishitja . Megjithatë, të gjitha format e tjera të ruajtjes së të drejtës së pronësisë janë të përjashtuara. Dispozita e mësipërme zbatohet veçanërisht për ruajtjen e të

drejtës së pronësisë e , të shtirë dhe të transmetuar dhe ruajtjen e të drejtës së pronësisë për të përfshirë ripërpunimin.

20. DHËNIA/TRANSFERIMI I TË DREJTAVE

- 20.1 Palët bien dakord që të gjitha të drejtat për punimet, dizajnet sipas kontratës, duke përfshirë por pa u kufizuar në shifra dhegrafikë , fotografi, software, mbledhje të dhënash dhe/ose rezultate të tjera të punës të krijuara nga Furnizuesi vetëm për Blerësin, duke përfshirë draftet, dokumentacionin dhe informacionin shoqërues (në vijim referuar bashkërisht si “Rezultatet e Punës”) janë pronë ekskluzive e Blerësit. Palët bien dakord më tej që Blerësi ka të drejtë të përdorë, shfrytëzojë, shtojë, modifikojë dhe përpunojë në ndonjë mënyrë tjetër këto Rezultate të Punës (përfshirë për qëllime të cilat tejkalojnë qëllimet tregtare të Blerësit dhe objektivin e ndjekur me urdhrin specifik) në çdo mënyrë të mundshme dhe t'i përpunojë ato dhe t'i lidhë ose ndërthurë me vepra ose sende të tjera dhe t'ua transferojë ato, në formë të modifikuar ose jo, shoqërive të grupit dhe palëve të treta.
- 20.2 Furnizuesi, duke lidhur këtë Marrëveshje, respektivisht jep të drejta ekskluzive, të paravokueshme të përdorimit të Rezultateve të Punës të përmendura më lart, të krijuara nga Furnizuesi dhe të mbrojtura nga ligji për të drejtën e autorit, si dhe të të gjitha rishikimeve dhe/ose modifikimeve të këtyre Rezultateve të Punës pa kufizime kohore, gjeografike ose kufizime të lidhura me përmbajtjen, të drejtat e përdorimit të të cilave mund të transferohen dhe/ose nënlicencohen tërësisht ose pjesërisht. Ky kalim i të drejtave përfshin të gjitha të drejtat e shfrytëzimit dhe përdorimit, duke përfshirë, por pa u kufizuar në të drejtën e riprodhimit, shpërndarjes, ekspozimit, prezantimit, performancës dhe shfaqjes, transmetimit, paraqitjes, qiramarrjes, dhënies me qira dhe të drejtat e bazës së të dhënave, të drejtat e prezantimit të videove dhe nëkinema (përfshirë të gjitha sistemet e ruajtjes audiovizive), të drejtat e tregtimit, si dhe të drejtat për riprodhimin nëpërmjet mediave video ose audio interaktive dhe jointeraktive, riprodhimin e transmetimeve me valë dhe aksesin publik, dixhitalizimin, disponueshmërinë online, transmetimin dhe riprodhimin, riprodhime të tjera publike dhe aksesin. Përfshihet gjithashtu e drejta për të modifikuar dhe përpunuar Rezultatet e Punës (në veçanti për t'i përkthyer ato në gjuhë të tjera dhe për t'i sinkronizuar) dhe për t'i kombinuar ose lidhur me punë ose artikuj të tjerë. Dhënia e mësipërme e të drejtave përfshin të gjitha llojet e njohura të përdorimit, duke përfshirë, por pa u kufizuar në përdorimin, aplikimin dhe/ose shfrytëzimin për qëllime reklamimi (si në formën e posterave, broshurave, ftesave, letrave, riprodhimeve në intranet dhe/ose internet, në faqet e internetit, në aplikacione dhe nga të gjitha mediat e tjera dixhitale), në kuadrin e librave, njoftimeve për shtyp dhe/ose veprave të tjera të shkruara, në kuadrin e filmave televizivë, videove të shoqërive , fotografive dhe/ose imazheve të tjera të regjistruara, në të gjitha format dixhitale (të tilla si në kuadrin e produkteve të multimedias, në faqet e internetit, në aplikacione, disponueshmëria në intranet dhe/ose internet) dhe/ose në imazhet artistike dhe/ose grafike (përfshirë logot) që paraqesin ose integrojnë Rezultatet e Punës. Dhënia e mësipërme e të drejtave për përdorimin e rezultateve të punës përfshin më tej të drejta për lloje të panjohura përdorimi si dhe përdorim në formë të përpunuar.
- 20.3 Nëse marrëveshjet e palëve të treta për të drejtat e autorit e lejojnë, Furnizuesi i transferon gjithashtu Blerësit të drejtën e autorit për Rezultatet e Punës si të tilla. Furnizuesi i transferon Blerësit të gjitha të drejtat shtesë të pronësisë intelektuale për Rezultatet e Punës, si dhe të drejtat e filmit.
- 20.4 Në lidhje me software e krijuar sipas kontratës nga Furnizuesi vetëm për Blerësin dhe/ose përshtatjet e software-it dhe/ose pjesët e software-it (përfshirë bazat e të dhënave të patentueshme, të dhënat ose strukturat e bazave të të dhënave dhe grumbullimet e të dhënave), zbatohen gjithashtu termat dhe kushtet e paraqitura më poshtë:
 - Nëse Rezultatet e Punës janë software të krijuar individualisht ose përshtatje të software-it standard, Blerësit do t'i jepen të drejta ekskluzive mbi software-in ose përshtatjet në fjalë. Përndryshe, të drejtat do të jepen mbi baza joekskluzive.

- Gjithashtu, Blerësit i jepen të drejtat në lidhje me software-in e krijuarsipas kontratës ose pjesë të softwarit individualisht, por edhe kur ato përfshihen në software të tjerë dhe/ose pjesë të software-it dhe në atë kuadër edhe bashkërisht, në veçanti e drejta për të shfrytëzuar, për të dhënë me qira, për të marrë me qira, për të riprodhuar, për të rikonfiguruar dhe për të modifikuar ato, për t'i transmetuar nëpërmjet valëve ose me linjë kabllore tërësisht ose pjesërisht, për t'i vënë ato në dispozicion për t'u tërhequr nga publiku pa pagesë ose për shqyrtim dhe për të raportuar publikisht për shërbimin. Kjo e drejtë përfshin gjithashtu shprehimisht dokumentacionin, materialet e trajnimit ose rezultatet e përkohshme të këtijsoftware-i.
 - Blerësi ka të drejtë të transferojë të drejtën e përdorimit të software-itqë është blerë prej tij në bazë të këtyre Afateve dhe Kushteve të Blerjes në rast ristrukturimi, themelimit të subjekteve të reja për qëllime kërkimi dhe zhvillimi (veçanërisht duke përfshirë për sipërmarrjet e përbashkëta të formuara në këtë kontekst), shitjeje të shoqërive ose nënkontraktimi të proceseve të IT-së në tërësi ose pjesërisht shoqërive të lidhura sipas përcaktimit në Marrëveshje, si dhe palëve të treta (në veçanti ofruesve të shërbimeve lidhur me këtë nënkontraktim të IT-së). Transferimi i të drejtave, mund që në këtë kuadër ,të jetë gjithashtu vetëm i pjesshëm dhe në kontekstin e objektit të licencës të përfshijë një autorizim përdorimi për Blerësin.
- 20.5 Furnizuesi i transferon gjithashtu Blerësit, plotësisht dhe në nivelndërkombëtar , të gjitha të drejtat mbi dhe nga shpikjet (përfshirë të drejtat nga patentat dhe modelet e përdorimit), markat dalluese, markat tregtare, emrat tregtarë dhe të drejtat e dizajnit mbi Rezultatet e Punës të krijuara për Blerësin. Ky transferim përfshin më tej të gjitha zbatimet dhe interesat në këto të drejta. Ky transferim nuk varet nga fakti nëse të drejtat, zbatimet dhe interesat janë të regjistruara apo të paregjistruara. Nëse ndonjë markë, markë tregtare, emër tregtar ose të drejta të dizajnit ekzistuese, mbrojtëse ose identifikuese, nuk mund të transferohet, seksioni 20.1 zbatohet sipas rastit.
- 20.6 Nëse Furnizuesi krijon software dhe/ose përshtatje me software-instandard me urdhër të Blerësit, kodin e burimit dhe i objektit, i krijuar në kuadër të ekzekutimit të urdhrat, i transferohet Blerësit në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe në formën e duhur. Nëse objekti i Marrëveshjes është ofrimi i një software standard dhe nëse Furnizuesi nuk ia transmeton Blerësit kodin e burimit dhe të objektit, Furnizuesi duhet që, nëse Blerësi dëshiron, të depozitojë kodin e burimit pranë një pale të tretë të përshtatshme, d.m.th. pranë një agjenti ruajtjeje, në kushte standarde të tregut dhe në favor të Blerësit.
- 20.7 Përveç të drejtës ekskluzive të pronësisë intelektuale, Blerësi fiton gjithashtu të drejtën ekskluzive mbi të gjitha objektet fizike dhe mjetet që mbajnë të dhënat e krijuara ose të transmetuara në kuadër të kësaj Marrëveshjeje nga Furnizuesi, ose mbi udhëzime të Furnizuesit për ekzekutimin e urdhrat të blerjes (p.sh. duke përfshirë, por pa u kufizuar në skica, drafte, dokumente, module, modele, vegla/mjete, filma, fotografi, diapozitivë, stampimet nga negativët, kaseta filmash, videokaseta, masterizime, USB, karta memorie, materiale reklamuese, postera, tabela, etiketa, materiale paketimi etj.). Dispozita e mësipërme zbatohet edhe nëse disa ose të gjitha objektet e cituara mbeten në posedim të Furnizuesit. Këto objekte duhet t'i dorëzohen Blerësit me kërkesë të tij.
- 20.8 Me pagesën e kompensimit të parashikuar, si shërbimet për të cilat Furnizuesi ka detyrime sipas kontratës, ashtu edhe transferimet e sipërpërmendura të të drejtave, do të konsiderohen të kompensuara plotësisht.
- 21. TË DREJTAT DHE PËRKATËSIA E PALËVE TË TRETA**
- 21.1 Për materialinfotografik, si dhe për publikimin dhe shfrytëzimin e tij sipas përcaktimit në seksionin 20.2, furnizuesi duhet të marrë paraprakisht lejet enevojshtme nga personat e paraqitur në imazh,
- 21.2 Nëse kontraktohen palë të treta, si fotografë, ilustrues, modele/ë, folës, këngëtarë etj., Furnizuesi shtrin tek Blerësi, mundësinë për të kufizuar objektin e shërbimit përpara se ata të kontraktohen, në drejtim të përcaktimit të tarifave dhe garancive ligjore.
- 21.3 Furnizuesi duhet të sigurojë që të gjithë krijuesit ose mbajtësit dytësorëtë së drejtës së autorit që janë përfshirë në prodhimin e shërbimeve dhe artikujve që do të ofrohen në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje, në bazë të një marrëveshjeje të lidhur me të, ose shërbimet ose punët e të cilëve i ka përdorur, të marrin një pjesë të të ardhurave që rrjedhin prej tyre, sipas kuptimit të Ligjit shqiptar "Për të drejtën e autorit".
- 21.4 Nëse Furnizuesi është (bashkë) autori i të gjitha përdorimeve të punës së Blerësit, Furnizuesi heq dorë nga kërkesa për njohjen e përkatësisë dhe u kërkon palëve të treta të përfshira prej tij në ekzekutimin e shërbimeve që të heqin dorë gjithashtu nga të drejtat e tyre për të drejtat e përkatësisë. Blerësi vendos për të drejtën e përkatësisë së Furnizuesit dhe/ose të çdo (bashkë) autori me emër, si dhe për çdo model citimi.
- 21.5 Furnizuesi, me anë të marrëveshjeve përkatëse (veçanërisht me çdo punonjës ose nënkontraktor të porositur prej tij), siguron që përdorimi kontraktor i Rezultateve të Punës dhe objekteve të tjera të transferuara prej tij të mos ndikohet negativisht nga ndonjë (bashkë) autorësi ose e drejtë tjetër e pronësisë industriale ("IP") dhe që Blerësit t'i atribuohen të drejtat e përshkruara në seksionet 20.1 deri në 20.7. Nëse është e nevojshme, Furnizuesi duhet të sigurojë të drejtat dhe/ose licencat e nevojshme. Furnizuesi paguan çdo tarifë licence.
- 22. SHKELJET E TË DREJTAVE TË PRONËSISË INDUSTRIALE (IP)**
- 22.1 Furnizuesi e mban Blerësin të padëmtuar ngapretendimet e palëve të treta, sipas dispozitave të seksionit 22.2, për shkeljen e të drejtave të IP-së, të palëve të treta nga Rezultatet e Punës dhe/ose objektet e furnizuara, kur përdorensipas përcaktimit në Marrëveshje. Ky detyrim për të mbajtur të padëmtuar blerësin përfshin të gjitha shpenzimet që i shkaktohen Blerësit nga ose në lidhje me pretendimin e palës së tretë.
- 22.2 Furnizuesi nuk është përgjegjës për shërbimet që ofrohen nga Blerësi. Blerësi e mban Furnizuesin të padëmtuar nga pretendimet e palëve të treta nëse dhe në masën që pretendimi përkatës paraqitet me arsyetimin se Furnizuesi ka vepruar sipas dëshirës së shprehur të Blerësit, megjithëse Furnizuesi e ka njoftuar Blerësin me shkrim për kundërshtimet e tij në lidhje me pranueshmërinë e veprimt.
- 23. DISENJO E KORPORATËS**
- Furnizuesi e përdor Disenjon aktual të Korporatës së Blerësit në mënyrën e duhur, veçanërisht në krijimin e shërbimeve të komunikimit dhe marrëdhënieve me publikun (p.sh. materiale reklamuese, shenja, filma, spote televizive ose radiofonike, paketimet e produktit, letrat tregtare , raportet e biznesit ose materiale të ngjashme, pavarësisht nëse janë për përdorim të brendshëm të Blerësit ose për qëllime të jashtme drejtuar palëve të treta). Në këtë drejtim, Blerësi duhet t'ia transmetojë Disenjon e Korporatës Furnizuesit në një format të përshtatshëm ose t'i mundësojë atij të aksesojë disenjon.
- 24. PAJTUESHMËRIA ME KËRKESAT LIGJORE NË SHËRBIMET E REKLAMIMIT DHE MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN**
- 24.1 Furnizuesi është përgjegjës për pajtueshmërinë e masave të reklamimit dhe marrëdhënieve me publikun të propozuara prej tij me dispozitat e ligjeve përkatëse për mbrojtjen e konsumatorit dhe mediat audiovizive të zbatueshme për këto masa. Furnizuesi mbulon çdo kosto që i është shkaktuar Blerësit si rezultat, dhe nga mospërbushja nga ana e Furnizuesit e detyrimit për të shqyrtuar dhe verifikuar siç duhet pranueshmërinë e masës së propozuar për marrëdhëniet me publikun sipas ligjeve në fuqi.
- 24.2 Furnizuesi nuk është përgjegjës për saktësinë e deklaratave objektive të bëra në lidhje me produktet dhe shërbimet e Blerësit në masën e propozuar të marrëdhënieve me publikun, nëse dhe në masën që Blerësi e ka miratuar këtë përmbajtje për publikim.

25. KONFIDENCIALITETI

- 25.1 Furnizuesi duhet ta përdorë të gjithë informacionin verbal ose atë me shkrim të dhënë nga Blerësi vetëm për qëllimet e përcaktuara në këtë Marrëveshje, të ruajë konfidencialitetin e tij dhe të mos ua bëjë atë me dije palëve të treta pa miratimin paraprak me shkrim të Blerësit. Furnizuesi duhet të vërë në dispozicion informacionin vetëm për ata punonjës dhe nënkontraktorë, nëse ka, të cilët janë të lidhur nga një marrëveshje konfidencialiteti të barasvlefshme me atë të përcaktuar në seksionin 25, dhe atyre të cilëve u nevojitet informacioni për të zbatuar Marrëveshjen ndërmjet Furnizuesit dhe Blerësit. Me kërkesë të Blerësit, Furnizuesi duhet t'i konfirmojë Blerësit me shkrim lidhjen e marrëveshjeve përkatëse.
- 25.2 Kriteri i konfidencialitetit i përcaktuar më lart shtrihet sipas rastit në kërkesën për kuotim dhe urdhër blerjeje si dhe në punën e kryer në këtë drejtim.
- 25.3 Detyrimet e mësipërme nuk zbatohen për informacionin që
- në kohën e zbulimit të tij ishte tashmë i njohur për Furnizuesin dhe Furnizuesi nuk kishte asnjë detyrim ndaj Blerësit për ta mbajtur atë konfidencial, ose
 - i është zbuluar Furnizuesit nga palët e treta që e kanë marrë dhe përcjellë këtë informacion pa shkelur asnjë detyrim konfidencialiteti, ose
 - në kohën e zbulimit të tij nga Blerësi ai ishte bërë tashmë i ditur për publikun, ose
 - u bë i ditur më pas për publikun jo për shkak të Furnizuesit.
- 25.4 Detyrimi i konfidencialitetit nuk zbatohet nëse zbulimi i informacionit para një gjykate ose një autoriteti shtetëror kërkohet nga një urdhër gjykate ose nga një urdhër i një autoriteti tjetër shtetëror për ekzekutimin e urdhrat. Nëse lejohet nga rrethanat specifike, Furnizuesi njofton menjëherë Blerësin para se informacioni t'i përcillet gjykatës ose autoritetit shtetëror.
- 25.5 Detyrimi i konfidencialitetit i përcaktuar më lart është i vlefshëm edhe pas ekzekutimit të urdhrat, përveç rastit kur në vijim ndodh një nga përjashtimet e cituara më sipër.

26. MBROJTJA E TË DHËNAVE

- 26.1 Secila palë duhet të respektojë në çdo kohë detyrimet e saj sipas ligjeve dhe rregulloreve në fuqi për mbrojtjen e të dhënave (duke përfshirë, por pa u kufizuar në Rregulloren (BE) 2016/679 "Rregullorja e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave" ("GDPR").
- 26.2 Informacioni sipas nenit 13 të GDPR-it, mbi mënyrën se si Blerësi përpunon të dhënat personale të personave fizikë në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje, mund të gjendet në adresën e mëposhtme: <https://www.bayer.com/en/corporate-compliance/data-privacy-information-for-specific-processing-activities>.

27. PËRGJEGJËSIA PËR DEFEKTET DHE GARANCI TË TJERA

- 27.1 Furnizuesi garanton se mallrat dhe/ose shërbimet që ka detyrimin të sigurojë nuk kanë ndonjë defekt që do të ndikonte negativisht në vlerën ose përshtatshmërinë e tyre për përdorim, se ato kanë cilësitë e kërkuara ose të përcaktuara në kontratë dhe janë të përshtatshme për përdorimin e specifikuar në Marrëveshje. Gjithashtu, Furnizuesi garanton se mallrat ose shërbimet që detyrohet të sigurojë përkojnë me kërkesat përkatëse të zbatueshme, duke përfshirë, por pa u kufizuar në kërkesat e sigurisë; kërkesat e autoriteteve shtetërore dhe të gjitha kërkesat e tjera përkatëse të parashikuara në kuadrin lokalpërkatës.
- 27.2 Përgjegjësia e furnizuesit shtrihet gjithashtu te pjesët e prodhuara dhe/ose të furnizuara nga nënkontraktorët dhe te shërbimet e kryera nga nënkontraktorët.
- 27.3 Blerësi duhet t'i raportojë Furnizuesit defektet në mallrat sipas kontratës sapo ato të identifikohen gjatë rrjedhës së zakonshme të veprimtarisë tregtare. Afati i njoftimit të defekteve përcaktohet në bazë të rrethanave individuale. Për defekte të dukshme, afati i njoftimit është të paktën pesë (5) ditë nga data e dërgesës. Për defektet e fshehura, afati i njoftimit është së paku pesë (5) ditë pas zbulimit të defektit.

- 27.4 Blerësi mban të drejtën e pronësisë mbi pjesët me defekt derisa ato të zëvendësohen. Pjesët me defekt i kthehen Furnizuesit në këmbim të dorëzimit dhe transferimit të të drejtës së pronësisë për produktet zëvendësuese.
- 27.5 Furnizuesi mbulon kostot e testimit, inspektimit dhe riparimit (duke përfshirë çdo kosto të cmontimit, instalimit dhe transportit). Kërkesa e mësipërme do të zbatohet gjithashtu edhe nëse konstatohet se në fakt nuk ka ekzistuar asnjë defekt. Çdo përgjegjësi e mundshme për dëmet nga ana e Blerësit në rast të pretendimeve të pajustificuara të garancisë mbetet e paprekur. Blerësi është përgjegjës në këtë masë vetëm nëse ka qenë i vetëdijshëm, ose nuk ka qenë i vetëdijshëm, nga pakujdesia se nuk ka ekzistuar në fakt asnjë defekt.
- 27.6 Në rastet urgjente, nëse nuk mund të pritët riparimimi nga Furnizuesi, pavarësisht nga të drejtat e tij juridike sipas garancisë, Blerësi mund ta riparojë vetë defektin ose me anë të palëve të treta, me shpenzimet e Furnizuesit dhe të kërkojë rimbursimin e shpenzimeve prej tij. Blerësi gëzon këtë të drejtë edhe nëse Furnizuesi nuk arrin ta riparojë defektin nga pakujdesia, pavarësisht se i është zgjatur afati brenda të cilit duhet të veprime, zgjatja e afatit është më se e tepërt, ose përpjekja për riparim në fund rezulton e pasuksesshme.
- 27.7 Nëse Furnizuesi ka dhënë një garanci për vetitë ose qëndrueshmërinë e objektit të furnizuar, Blerësi mund të ngre pretendime sipas garancisë, përtej të drejtave të tij që rrjedhin nga defektet.

28. REKURSI I FURNIZUESIT

- 28.1 Përveç pretendimeve që rrjedhin nga defektet, Blerësi ka gjithashtu akses të pakufizuar në pretendimet ligjore të rekurisit të Furnizuesit brenda një zinxhiri furnizimi (rekursi i furnizuesit). Në veçanti, Blerësi ka të drejtë të specifikojë llojin e saktë të rregullimit (riparim ose zëvendësim) që shitësi i detyrohet klientit të tij në rastin konkret. Për rrjedhojë, mundësitë e tij ligjore nuk janë të kufizuara.
- 28.2 Përpara se Blerësi të pranojë ose të respektojë një pretendim garancie të paraqitur nga një prej klientëve të tij, ai njofton Furnizuesin duke dhënë një përshkrim të shkurtër të situatës dhe kërkon përgjigje me shkrim. Nëse përgjigjja nuk merret brenda një periudhe të arsyeshme dhe nuk mund të arrihet marrëveshje për një zgjidhje, pretendimi i garancisë i respektuar në të vërtetë nga Blerësi i kalon klientit të tij. Në këtë rast, Furnizuesi duhet të paraqesë prova për të kundërtën.
- 28.3 Pretendimet e blerësit nga rekursi i furnizuesit janë të vlefshme edhe nëse mallrat i janë nënshtruar përpunimit të mëtejshëm (p.sh. duke u inkuorporuar në një produkt tjetër) përpara se t'i shiteshin një konsumatori ose ndonjë prej klientëve të tij nga Blerësi .

29. PERFUNDIMI

- 29.1 Nëse Marrëveshja është një detyrim i vazhdueshëm, Blerësi, në rast të ushtrimit të të drejtave të zakonshme të përfundimit të marrëdhënies , ka gjithashtu të drejtën e përfundimit të pjesshëm, nëse diçka e tillë është e pritshme në mënyrë të arsyeshme nga Furnizuesi.
- 29.2 Nëse Marrëveshja është një detyrim i vazhdueshëm, ajo mund të përfundohet me shkak, pa njoftim. Shkak i mjaftueshëm ekziston veçanërisht në rastet e mëposhtme:
- Furnizuesi nuk përmbush një detyrim të kontratës dhe nuk e korrigjon mospërmbushjen brenda një periudhe të arsyeshme kohe të caktuar nga Blerësi, shoqëruar merrezikun e përfundimit.
 - Nëse afati për të garantuar përmbushjen nuk mund të zgjatet në varësi të llojit të shkeljes dhe Furnizuesi nuk e ka korrigjuar me sukses shkeljen, pavarësisht nga paralajmërimi.
 - Furnizuesi nuk ka përmbushur detyrimin e tij për të mbajtur tatimindhe/ose kontributet e sigurimeve shoqërore.
 - Ka pasur një përkeqësim të konsiderueshëm të situatës financiare të Furnizuesit, e cila rrezikon zbatimin e Marrëveshjes.

30. PËRGJEGJËSIA

- 30.1 Furnizuesi duhet ta mbajë Blerësin të padëmtuar nga pretendimet e përgjegjësisë të prodhuesit nëse shkaku është brenda zonës së kontrollit ose operimit të Furnizuesit ose nënkontraktorëve të tij.
- 30.2 Në kuadrin e përgjegjësisë së tij për dëmet sipas nenit 30.1, Furnizuesi duhet të rimburojë gjithashtu çdo shpenzim të pësuar nga Blerësi ose të lidhur me një fushatë tërheqjeje të kryer sipas ligjit. Sa më sipër vlen edhe për urdhrat e tërheqjes paraprake.
- 30.3 Blerësi është përgjegjës për udhëzimin e autoriteteve shtetërore në përputhje me Aktin e Sigurisë së Produktit. Blerësi koordinohet me Furnizuesin sipas nevojës.
- 30.4 Përveç kësaj, Furnizuesi është përgjegjës në përputhje me dispozitat ligjore.

31. AFATET E PARASHKRIMIT

- 31.1 Nëse nuk është rënë dakord shprehimisht ndryshe, zbatohen afatet ligjore të parashkrimit. Pavarësisht nga sa më sipër, zbatohen dispozitat e parashtruara më poshtë.
- 31.2 Afati i përgjithshëm i parashkrimit për pretendimet kontraktuale që ngrihen për shkak të defekteve materiale dhe të metave lidhur me titujtë dy (2) vjet pas dorëzimit të objektit të Marrëveshjes tek Blerësi në vendin e ekzekutimit.
- 31.3 Pretendimet jokontraktuale që ngrihen për shkak të defekteve materiale dhe të metave në të drejtën e pronësisë dhe pretendimet kontraktuale për arsye të ndryshme nga defektet u nënshtrohen afateve ligjore të parashkrimit.
- 31.4 Afati i parashkrimit për ankesat e arsyetuara për defekte zgjatet me periudhën ndërmjet ankesës për defektin dhe zgjidhjes së saj. Nëse objekti i furnizuar zëvendësohet në tërësi, afati i parashkrimit fillon nga e para. Në rast të një zëvendësimi të pjesshëm, afati i parashkrimit zbatohet për pjesët e zëvendësuara. Afati i parashkrimit nuk do të fillojë nga e para nëse Furnizuesi në mënyrë të dukshme nuk po vepron në përbushje të detyrimit të tij për të korrigjuar defektet.

32. TATIMI NË BURIM

- 32.1 Blerësi ka të drejtë të mbajë nga kompensimi që i detyrohet sipas kësaj Marrëveshjeje çdo tatim në burim, mbajtja e të cilit është përgjegjësi ligjore e Blerësit. Çdo tatim i mbajtur në burim trajtohet për të gjitha qëllimet e kësaj Marrëveshjeje sikur t'i jetë paguar Furnizuesit nga Blerësi. Furnizuesi duhet të marrë sa më shpejt nga Blerësi një faturë tatimore që tregon shumën e tatimit të mbajtur në burim, e ciladokumenton shumën e tatimit të mbajtur dhe të zbritur. Dispozitat e traktateve të zbatueshme për tatimin e dyfishitë ndërmjet vendit të juridiksionit të Furnizuesit dhe Shqipërisë, në masën e zbatueshme, mund të ulin ose eliminojnë tatimin në burim me kusht që Furnizuesi të përbushë kërkesat e zbatueshme të legjislacionit shqiptar për paraqitjen e certifikatës së rezidencës tatimore dhe dokumenteve të tjera dhe kërkesat ligjore lidhur me detyrimet e Furnizuesit për këtë qëllim.
- 32.2 Nëse Blerësi nuk mund ta zbrisë tatimin në burim nga pagesa për shkak se kompensimi shuhet përmes kompensimit të detyrimeve të ndërsjella, Furnizuesi duhet t'ia paguajë më vete Blerësit tatimin në burim. Nëse Blerësi është treguar i pakujdesëm dhe nuk ka zbritur tatimin në burim, edhe pse sipas ligjit është i detyruar të paguajë atë tek autoritetet tatimore për llogari të Furnizuesit, Furnizuesi do të asistojë Blerësin në të gjithë procedurat e nevojshme për të përfituar një rimbursim nga autoritetet tatimore. Nëse autoritetet tatimore nuk i rimburojnë tatimet në burim të paguara më pas, Furnizuesi do t'i rimburojë menjëherë Blerësit shumën e tatimit që i detyrohet me ligj.

33. TVSH

Të gjitha shumat e përcaktuara të kompensimit janë shuma neto. Nëse Furnizuesi detyrohet sipas ligjit, tatimi mbi vlerën e shtuar duhet të

paguhet pas marrjes së një fature të saktë në kuptim të ligjit "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", përveç shumës së përcaktuar në faturë.

34. ORIGJINA E MALLRAVE/STATUSI DOGANOR**34.1 Origjina e mallrave**

Mallrat e furnizuara duhet të plotësojnë kërkesat e origjinës të Sistemit të Përgjithësuar të Preferencave të BE-së në masën e zbatueshme, përveç rasteve kur parashikohet shprehimisht ndryshe në pranimin e urdhrat të porosisë. Furnizuesi duhet të lëshojë të gjitha deklaratat e furnizuesve të kërkuara nga legjislacioni shqiptar, duke përfshirë por pa u kufizuar në ato që përafrojnë Rregulloren Implementuese (BE 2015/2447), si dhe të konfirmojë statusin preferencial të produkteve të furnizuara prej tij. Kjo kërkesë nuk plotësohet nga cilësimi i vendit të origjinës në faturë. Furnizuesi është përgjegjës për saktësinë e deklaratës së furnizuesit dhe është përgjegjës ndaj Blerësit për çdo dëm të shkaktuar. Një deklaratë afatgjatë e furnizuesit mund të lëshohet me kërkesë të Blerësit, megjithatë, në çdo rast duhet të lëshohet një deklaratë individuale e furnizuesit. Sidoqoftë, me kërkesë të Blerësit, në çdo rast duhet të lëshohet një certifikatë e origjinës, nëse është e nevojshme.

34.2 Statusi doganor

Nëse nuk është rënë dakord ndryshe ndërmjet Furnizuesit dhe Blerësit ose kur nuk është rasti, Furnizuesi duhet të furnizojë gjithmonë mallra nga Bashkimi Evropian për dërgesa nga një pikë ngarkimi e Bashkimit Evropian ("BE"-së). Furnizuesi duhet të tregojë statusin doganor të mallrave në dokumentet e tij të transportit (p.sh. faturën e ngarkesës). Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe: mallrat që dërgohen nga një pikë ngarkimi e BE-së janë mallra nga Bashkimi Evropian.

34.3 Dogana dhe Tregtia e Jashtme

Përveç sa më lart, zbatohen "Udhëzimet e BAYER-it për Furnizuesin - Afatet dhe Kushtet për Doganat dhe Tregtimin e Jashtme".

34.4 Qëndrueshmëria

Furnitori është i detyruar ta organizojë biznesin e tij me Bayer në përputhje me pritshmëritë e Bayer-it në lidhje me të drejtat e njeriut dhe mjedisin si edhe tema të tjera të qëndrueshmërisë, siç përcaktohet në Kodin e Sjelljes së Furnitorit të Bayer-it versioni ("Bayer SCoC"), i datës 31 dhjetor 2022, i cili mund të aksesohet përmes <https://www.bayer.com/en/procurement/supplier-code-of-conduct>, Versioni i datës 31 dhjetor, 2022. Bayer rezervon të drejtën për të ndryshuar këtë Klauzolë të Qëndrueshmërisë si edhe në SCoC të Bayer-it në rast se pritshmëritë e Bayer-it në lidhje me të drejtat e njeriut dhe mjedisin ndryshojnë dhe do të informojë Furnitorin për këtë sa më shpejt të jetë e mundur. Furnitori pranon pajtueshmërinë e vazhdueshme me këtë SCoC ose klauzolë të ndryshuar, sipas rastit

Furnitori do të vendosë në dispozicion dispozitat thelbësore të SCoC të Bayer-it te furnitorët e tij dhe garanton që dispozitat thelbësore të SCoC të Bayer-it të respektohen nga vetë Bayer dhe furnitorët e tij, duke përfshirë qasjen në portalin e ankesave të Bayer-it të, specifikuar SCoC të Bayer-it.

Bayer rezervon të drejtën për të vlerësuar, kontrolluar ose audituar (duke bërë auditime në vendndodhje ose në distancë, pyetësorë në internet ose të printuar, përmes sistemeve të njohura të certifikimit ose sistemeve të auditimit etj.) për të garantuar dhe verifikuar përputhshmërinë me sa u tha më sipër. Një vlerësim, kontroll apo auditim mund të kryhet drejtpërdrejt nga Bayer ose nga një palë e tretë e kualifikuar.

Furnitori, pa vonesa të paarsyeshme, (i) i raporton Bayer-it me shkrim çdo rrezik të identifikuar dhe shkelje të parimeve të përshkruara në SCoC të Bayer-it dhe (ii) merr masat e duhura korrigjuese për të parandaluar, përfunduar ose reduktuar shkeljen. Bayer rezervon të drejtën që (i) të zbatojë konceptin për përfundimin ose reduktimin e një shkeljeje dhe (ii) të kërkojë bashkëpunimin e Furnitorit në këtë drejtim. Nëse Furnitori nuk përbush kërkesat e SCoC të Bayer-it dhe pasi të ketë kaluar një periudhë tolerimi prej tre muajsh pa eliminimin e shkeljeve, Bayer rezervon të

drejtën (i) të pezullojë marrëveshjen derisa këto shkelje të korrigjohen, ose (ii) të japë njoftim të jashtëzakonshëm për zgjidhje të marrëveshjes, pas skadimit të pasuksesshëm të afatit kohor të planifikuar për ekzekutim dhe njoftimi të jepet sipas gjykimit të vetëm të Bayer.

Furnitori pranon dhe mbështet përpjekjet e Bayer-it për përfshirjen dhe diversitetin e furnitorëve, angazhimin e tij për pjesëmarrjen e bizneseve të ndryshme dhe ndalimin e trajtimit diskriminues në zinxhirin e furnizimit, siç përshkruhet në SCoC të Bayer-it. Furnitori do të bëjë përpjekjet e arsyeshme për të punësuar furnitorë dhe nënkontraktorë të ndryshëm të kualifikuar, aty ku është e përshtatshme dhe e mundshme, të mbajë shënime për funksionin e tyre dhe të jetë në gjendje të dorëzojë një raport sipas kërkesës së Bayer-it për përqindjet e shpenzimeve me furnitorë të ndryshëm.

Furnizuesi do të dëmshpërblejë dhe mbajë Bayer dhe filialet e tij, duke përfshirë Bayer AG (të gjitha filialet e Bayer të listuara në https://www.bayer.com/sites/default/files/GDIS_Companies_EN.pdf) të padëmtuar nga çdo dëmtim, pretendime nga palët e treta, gjoba, ose humbjet që vijnë nga shkeljet e detyrimeve të përshkruara këtu ose në SCoC.

35. PASUESIT DHE ÇAKTIMI I PALËVE TË TRETA

Kjo marrëveshje është e detyrueshme dhe e vlefshme për përbushjen e interesave të palëve, dhe të pasuesve të tyre respektivë ose palëve të cilave i transferohen të drejtat e detyrimit objekt kontrate. Të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kjo marrëveshje nuk mund t'i kalohen për ekzekutim palëve të treta, apo të transferohen ose cedohen, plotësisht ose pjesërisht, nga asnjëra palë në favor të ndonjë pale tjetër pa pëlqimin paraprak me shkrim të palës tjetër kontraktore, por përjashtimisht, Bayer mund t'i kalojë për ekzekutim palëve të treta, apo të transferojë ose cedojë, plotësisht ose pjesërisht, të drejtat dhe detyrimet e tij sipas kësaj marrëveshjeje pa pëlqimin paraprak me shkrim të palës tjetër të (a) çdo shoqëri e grupit, ose (b) pasues ose palë që i transferohen të drejtat e detyrimit, qoftë nëpërmjet bashkimit me përthithje ose me krijimin një shoqërie të re, blerje ose mënyrë tjetër tjetërsimi, të aktivitetit ose aseteve të Bayer, ose pjesëve të tyre, me të cilat lidhet lënda e kësaj marrëveshjeje.

36. DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

- 36.1 Furnizuesi lejohet të citojë marrëdhënien e biznesit me Blerësin ose t'i referohet asaj në materialet informuese dhe reklamuese vetëm me miratimin e shprehur me shkrim të Blerësit.
- 36.2 Furnizuesi mund të transferojë pretendime ndaj Blerësit që nuk janë pretendime monetare vetëm me miratimin e shprehur të Blerësit.
- 36.3 Blerësi mund t'i transferojë Marrëveshjen dhe të drejtat dhe detyrimet që lidhen me të në çdo kohë dhe pa miratimin e Furnizuesit, shoqërisë "Bayer AG" ose shoqërive të grupit të saj, , ose në lidhje me shitjen apo transferimin e të gjithë ose shumicës së (i) aktivitetit të tij tregtar , (ii) një njësie të caktuar të aktivitetit tregtar ose (iii) një vendndodhje të caktuar, ose në lidhje me një bashkim ose formë tjetër konsolidimi të Blerësit ose ndonjë prej shoqërive të grupit të tij me një subjekt tjetër.
- 36.4 Furnizuesi mund të kompensojë vetëm shumat e pakundërshtuara ose ato të bazuara ligjërisht. Nëse Furnizuesi ka të drejtë të ndalojë ekzekutimin e kontratës, ai mund ta bëjë këtë vetëm për pretendimet që burojnë nga e njëjta marrëdhënie kontraktuale.
- 36.5 Përndryshe, zbatohen dispozitat ligjore që rregullojnë të drejtat e kompensimit dhe të mbajtjes nga pagesa.
- 36.6 Furnizuesi duhet të njoftojë menjëherë Blerësin me shkrim për çdo transferim të Marrëveshjes sipas ligjit dhe për çdo ndryshim në emrin e shoqërisë së tij.

36.7 Forca Madhore: Kur një Palë nuk është në gjendje për të përbushur detyrimet e saj sipas kësaj Marrëveshjeje,, tërësisht ose pjesërisht, për shkak të zjarrit, përmblyjes, shpërthimit, tërmetit, trazirave, fatkeqësive natyrore, luftës ose aktiviteteve terroriste, pa faj të Palës që deklarohet forcën madhore dhe që nuk rezulton në asnjë mënyrë nga pakujdesia ose shkelja me dashje për të përbushur detyrimet e saj sipas kësaj Marrëveshjeje, duke përjashtuar detyrimet e pagesës ("Ngjarja e Forcës Madhore"), këto detyrime pezullohen për aq sa preken nga Ngjarja e Forcës Madhore dhe, në lidhje me këto detyrime të pezulluara, asnjëra Palë nuk do të jetë përgjegjëse ndaj palës tjetër ose nuk do të konsiderohet se është në shkelje të kësaj Marrëveshjeje për arsye të vonësës në ekzekutim ose moszbatimit të kontratës.

36.8 Për këtë Marrëveshje zbatohet legjislacioni shqiptar, duke përjashtuar rregullat për konfliktin e ligjeve. Konventa e OKB-së, datë 11 prill 1980, "Për marrëveshjet për shitjen ndërkombëtare të mallrave" nuk zbatohet.

36.9 Nëse një urdhër blerjeje i referohet INCOTERMVE pa treguar vitin, INCOTERMAT zbatohen në versionin që është në fuqi në kohën e urdhrimit të blerjes.

36.10 Gjykatat e Shqipërisë kanë juridiksion ekskluziv për çdo mosmarrëveshje lidhur me këtë Marrëveshje

36.11 Nëse dispozita individuale të Marrëveshjes janë ose bëhen të pavlefshme ose të pazbatueshme tërësisht ose pjesërisht, dispozitat e mbetura nuk do të preken nga kjo pavlefshmëri.

36.12 Në rast përjashtimi të dispozitave nga Marrëveshja, apo nëse ato janë të pavlefshme ose të pazbatueshme, përmbajtja e marrëveshjes do të jetë në çdo rast në përputhje me kërkesat ligjore. Vetëm në rast të kundërt dhe nëse asnjë interpretim shtesë i Marrëveshjes nuk ka përparësi ose nuk është i mundur, palët zëvendësojnë dispozitën e pavlefshme ose të pazbatueshme me një dispozitë të vlefshme dhe të zbatueshme, të afërt në aspektin ekonomik, me dispozitën fillestare, duke marrë parasysh interesat e tyre të përbashkëta.

Përditësuar: Tiranë, janar 2024